



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 3) dhe 18), dhe në pajtim me nenin 7, paragrafi (1), pika 4), nenet 24 dhe 41 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21 dhe 74/24), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

POLITIKË PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E POLITIKËS SË MENAXHIMIT DHE INVESTIMIT TË REZERVAVE VALUTORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

1. Në Politikën për menaxhim dhe investim të rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 223/15 dhe 141/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 132/22), pas pikës 3) shtohet pikë e re 3-a), e cila thotë:

"3-a. Gjatë menaxhimit të rezervave valutore mund të merret parasysh edhe angazhimi i Bankës Popullore lidhur me kontributin për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër, rritjen e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike dhe përgjegjësinë sociale, pa cenuar parimet e sigurisë, likuiditetit dhe përfitimit".

2. Në pikën 7), paragrafi (8) ndryshon dhe bëhet:

"Obligacionet e korporatave – blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë të borxhit të emetuara nga shoqëri të huaja financiare dhe jofinanciare."

Pas paragrafit (8) shtohet paragrafi i ri (9) që thotë:

"Pjesë të aksioneve në fondet e investimeve – blerjen dhe shitjen e pjesës së aksioneve në fondet e investimeve që janë të regjistruara jashtë vendit dhe për të cilat instrumentet financiare janë mjeti kryesor i lejuar në Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore."

3. Pika 8) ndryshon dhe bëhet:

"Lista e vendeve të lejuara ku mund të vendosen rezerva valutore, emetuesit e letrave me vlerë dhe institucionet financiare me të cilat lejohen transaksionet në menaxhimin e rezervave valutore, shoqëritë e menaxhimit të fondeve të investimeve, si dhe kufijtë sasiore të ekspozimit përcaktohen në Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore."

4. Në pikën 9), fjala: "guvernatori" zëvendësohet me fjalët: "Këshilli Ekzekutiv".

5. Në pikën 13), paragrafët (1) dhe (2), fjala: "guvernatori" zëvendësohet me fjalët: "Këshilli Ekzekutiv".

6. Në pikën 17), paragrafët (1) dhe (2), fjala: "guvernatori" zëvendësohet me fjalët: "Këshilli Ekzekutiv".

7. Në pikën 19), paragrafi (1), fjala: "guvernatori" zëvendësohet me fjalët: "Këshilli Ekzekutiv".

8. Kjo politikë hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

**P. nr. 02-34557/6
9 tetor 2024
Shkup**

**Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска**